



**MINISTRIA E BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT
RURAL**

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE VLORË

PROJEKT: KËRKIM NË FERMË

RAPORT PËRFUNDIMTAR

Titulli i projektit: “Rehabilitimi i agrumishteve të dëmtuara nga ngricat”.

Afati i zbatimit: Janar 2017 - Dhjetor 2017

Drejtues i projektit:

Lida Lazaj

TITULLARI:

Dr. Aulona Veizi

1. Hyrje

Gjatë muajit Janar 2017 vendi ynë u përfshi nga temperatura ekstremisht të ulta: -8 -12°C për një periudhë gati 10 ditore, gjë që shkaktoi dëme serioze në kulturën e agrumeve.

2. Qëllimi: Evidentimi i dëmeve nga ngricat në parcelat me agrume ku do të ngrihet studimi, si dhe përcaktimi i teknologjisë së duhur dhe efikase për rehabilitimin e tyre. Qëllimi është që t'i keshillojmë fermerët si duhet të veprojnë për rehabilitimin e agrumeve në rast përsëritje të situatës sinoptike të 2017.

3. Vendi i ngritjes së kërkimit: Baza eksperimentale Shamogjin dhe parcelë private prej 1.5 ha në Bamatat- Delvinë me fermer Jetmir Mehmeti.

4. Metodika e përdorur

E ndoqëm këtë kërkim edhe në BEP Shamogjin për vet faktin se në koleksionin e agrumeve janë tre specie agrume, portokalle, mandarina dhe limona; mbi pesë nënshartesa të ndryshme të moshës 7 vjeçare dhe konkluzionet e dëmtimeve nga ngricat janë më të sakta dhe më të plota.

Në muajin Prill u bë evidentimi i dëmtimeve për çdo specie, kultivarë dhe nënshartesë, të cilat i kemi pasqyruar në studimin e qëndrueshmërisë ndaj ngricave.

U pa shkalla e dëmtimit të tyre:

Shkalla e parë, dëmtimi i masës gjethore (përzhitje e gjethëve), shkalla e dytë dëmtimi i degëve skeletore dhe shkalla e tretë dhe më e rëndë sigurisht dëmtimi i trungut dhe degëve kryesore.

Duke parë shkallën e dëmtimit përcaktuam mënyrën e krasitjes dhe gjithë shërbimet e tjera agroteknike.

Në tërësi koleksioni i agrumeve pati dëmtim të masës gjethore, u vyshkën, morën ngjyrë kafe dhe u rrëzuan më vonë. Pjesa më e madhe çelën dhe u zhvilluan normalisht në varësi të kultivarit dhe nënshartesës përkatëse. Nuk u rigjeneruan më ata kultivarë që patën dëmtime të trungut dhe degëve kryesore sipas specieve si më poshtë:

Limona 36 rrënjë, portokalle 49 dhe mandarina 27 rrënjë. 660 agrume janë rehabilituar tërësisht, me kurorë të plotë dhe lastar që arrijnë nga 40cm deri në 2 m.

Në një pjesë të agrumeve të thara ka çelur nënshartesa.

Teknologjia e përdorur:

-Kujdes i veçantë u tregua me krasitjen, nuk u bënë ndërhyrje të menjëhershme pas ngricave por pasi u pa qartë shkalla e dëmtimit dhe reagimit të çdo kultivari. Në këtë mënyrë shmangëm prerjet e rënda, të panevojshme dhe dëmtimin e skeletit e kurorës së bimës.





Figurë 1-5. Pamje nga puna për rehabilitim të koleksionit të Agrumeve BEP Shamogjin.

- U përdor plehrim i gjelbër (bathë) në një pjesë të mandarinave e cila u përmbys me anë të punimit në kohën e lulëzimit.
 - U plugua dhe frezua gjithë sipërfaqja në pranverë.
 - Punim me belënërreshtat e agrumeve të shoqëruara me pleh kimik DAP dhe Superfosfat – 3 herë në pranverë dhe në vjeshtë.
 - Vadijtje me pika gjatë gjithë verës në çdo 10 ditë.
 - Plehrim me Ure dhe Nitrat të shoqëruara me ujitje 3 herë.
- Siç shihet edhe në fotot më poshtë sot ne kemi një koleksion agrume tërësisht të rehabilituar.



Figurë 6;7. Koleksioni i Agrumeve BEP Shamogjin

Për vitin 2018, do të vazhdojnë shërbimet agroteknike që përmendëm më lart dhe do të shartojmë të gjitha nënshartesat e çelura me kultivarët përkatës sipas skemës.

4.1 Në parcelën e fermerit Jetmir Mehmeti:

Ndodhet në fshatin Bamatat –Delvinë, me sipërfaqe 1.5 ha dhe me numër bimësh 1100 rrenjë mandarina Klementinë të moshës dy vjeçare nga të cilat 550 bimë mbi nënshartesën Nerënxë dhe pjesa tjetër mbi nënshartesën Trifoljat. Mbi nënshartesën Trifoljat bimët patën qëndrueshmëri të lartë ndaj ngricave, ndërsa mbi nënshartesën Nerënxë kultivari Klementinë rezultoi me qëndrueshmëri shumë të ulët, tharje në masë të bimëve. Ishte kjo arsyeja që vendosëm ta bënim kërkimin në fermë pikërisht në këtë parcelë të fermerit Jetmir Mehmeti, ku dukshëm vihej re qëndrueshmëria e të njëjtit kultivar mbi dy nënshartesat të ndryshme.

Studimi u ngrit në tre variante si më poshtë :

V.1. Rehabilitimi i bimëve që u janë dëmtuar vetëm masa gjethore me anë të shërbimeve agroteknike.

V.2. Rehabilitimi i bimëve që u janë dëmtuar një pjesë e degëve skeletore dhe trungut, nepërmjet krasitjes dhe shërbimeve të tjera agroteknike.

V.3. Shkulje e bimës së dëmtuar dhe zëvendësimi me bimë të re.

4.2 Treguesit qëu morrën në studim:

- Rritja e diametrit të trungut (Prill - Nëntor),

- Rritja mesatare e lastarëve dhe volumi i kurorës (Prill - Nëntor).

Në gjithë agrumishten për të tre variantet u bënë shërbimet si më poshtë:

- Vadtje me pika shoqëruar me plehra të tretshëm në ujë (sipas bilancit të hartuar) 2 herë në javë.


- Spërkatje 1 herë në javë kundër tenjës Minuese dhe dëmtuesve të tjerë.

Punim dhe frezim 1 herë në gjithë sipërfaqen.

Specialistët e QTTB kanë patur kontakte dhe bashkëpunim të vazhdueshëm me fermerin Jetmir Mehmeti për korrektësinë e kryerjes së shërbimeve të mësipërme.

Në fund të muajit Nëntor u bënë matjet për marrjen e treguesve sipas metodikës dhe sipas varianteve kemi këto rezultate:

V1: Rehabilitimi i bimëve ku është dëmtuar vetëm masa gjethore.



Grafikë 1; 2. Të dhëna të diametrit dhe lartësisë në bimët e koleksionit të Agrumeve V1 dhe foto bimë ku është dëmtuar masa gjethore.

Siç shihet nga grafikët por edhe nga fotoja bimët që iu dëmtuan vetëm gjethet të cilat morën ngjyrë kafe dhe më vonë u rrëzuan u rigjeneruan totalisht, e gjithë kurora u mbush me gjelbërim të ri e patën rritje lastarësh 5-8 cm dhe diametër të trungut 6-9 cm.

V2. Rehabilitimi i bimëve që u janë dëmtuar degët skeletore dhe trungu.

Në këtë variant u pa që bimët dy vjeçare të kultivarit Klementina/Nerënxë që patën dëmtim të shkallës së dytë u thanë, nuk u rigjeneruan me gjithë shërbimet agroteknike që u përmendën më sipër.



Figurë 8. Rehabilitimi i bimëve ku janë dëmtuar degët skeletore dhe trungu.


V3. Shkulje e bimës së dëmtuar dhe zëvendësimi me bimë të re.

Së bashku me fermerin menduam që një pjesë e mandarinave/Nerënxëtë shkulej dhe të zëvendësohej me fidanëtë rinj mbi nënshartesen Trifoljatë.



Figurë 8. Fidanë i mbjellë në muajin Prill


Muaji Nëntor



Grafikë 3; 4. Të dhëna të diametrit dhe lartësisë në bimët e koleksionit të Agrumeve V2.

Siç shihet nga fotot dhe grafikët fidani i rimbjellë ka rritje të bujshme në gjithë kurorën nga muaji Prill deri në muajin Nëntor, diametri nga 18 në 32 mm dhe lartësia e bimes nga 107 në 136.6cm.

Bima e mbjellë në pranverë në fund të vitit të parë (Varianti 3), pati një zhvillim të mirë duke iu afruar treguesve të rritjes së bimëve të ripërtërira nga ngricat (Varianti 1).



Grafikë 5; 6. Të dhëna të diametrit dhe lartësisë në bimët e kolek. të Agrumeve V1 dhe V3.

5. Konkluzione dhe mesazhe për fermerin

-Në zonën e Delvinës kultivari Klementinë mbi Trifoljatë në agrumishte të re ka qëndrueshmëri të lartë ndaj ngricave, ndërsa mbi nënshartesën Nerënxë ka qëndrueshmëri të ulët, prandaj rekomandojmë të mbillen sa më pak fidanë mbi këtë nënshartesë pasi ka nënshartesë të tjera me qëndrueshmëri shumë të lartë siç janë Citrumelo dhe Cintrazhet në përgjithësi.

- Kur kemi të bëjmë me dëmtime të shkallës së parë nuk duhet të shqetësohemi pasi me rritjen e temperaturave dhe nëpërmjet shërbimeve agroteknike këto dëme janë plotësisht të riparueshme

- Nëse kemi dëmtime të shkallës së dytë dhe të tretë (janë dëmtuar degët skeletore dhe trungu), është më ekonomike të shkulen dhe të rimbillen fidanë të rinj pasi fitojmë kohë në rinovimin total të agrumishtes. Por kjo nuk do të thotë që të ndërmarrim vendime të nxituara për vetë koston që ka ky proces.

Drejtues Projekti:

**Lida Lazaj
Llambro Dhima**

Shef i financës:

Luljeta Malaj

TITULLARI

Dr. Aulona Veizi